

MBLEDHJA E KUVENDIT TË LSHPM

# REZULTATET, NXITJE PËR AKTIVITETE TË REJA

Kuvendi i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë më 18 dhjetor 2018 kanë mbajtur seancën e 8-të me të cilën ka udhëhequr kryetari i Kuvendit të LSHPM Besnik Pocesta. Në seancë të pranishmëve fillimisht ju drejtua kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, i cili në fjalimin e tij dha një analizë të të arriturave gjatë vitit të kaluar 2018 dhe theksoi:

-Të gjitha propozim-materialet për këtë seancë i ka shqyrtuar dhe mbështetur Këshilli ekzekutiv i LSHPM me konstatimin se me rezultatet e arritura duhet të jemi krenarë të gjithë sepse ato janë merita thuajse e secilit individ, anëtar i lidhjes sonë. Edhe këtë vit 2018, arritëm t'i realizojmë detyrat programore dhe të realizojmë rezultatet pozitive financiare. Kështu në vazhdimësi punojmë gjatë të gjitha viteve të të dyja mandateve sa jam unë kryetar i LSHPM. Dëshiroj që puna e këtillë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Me punë ekipore arritëm që Revynë republikane tradicionale të këngëve, muzikës dhe valleve dhe Garat sportive republikane të pensionistëve t'i realizojmë në nivelin e duhur, e ajo mund të thuhet edhe për piknik takimet, përmes të cilave zgjerojmë miqësitë dhe bashkëjetesën mes pensionistëve. Në



fushën e bashkëpunimit ndëretnik një kohë të gjatë jemi shembull për gjeneratat e reja. Konsiderueshëm është rritur edhe ndihma e paktyeshme financiare nga ana e LSHPM për shoqatat e pensionistëve, e cila gjatë vitit të kaluar ka qenë 990.000, ndërsa këtë vit 875.000 denarë. Rezultatet e arritura gjatë aktiviteteve dhe në punën financiare janë një platformë solide për mbindërtim dhe suksese të reja të Lidhjes dhe shoqatave gjatë viteve në vijim. Duke u uruar Vitin e Ri 2019, kryetari Argirovski u dëshiroi të pranishmëve, por edhe të gjithë pensionistëve të tashëm dhe të ardhshëm fat, shëndet të mirë dhe plotësim të ditëve pensioniste. Sipas rendit të ditës fjalim për Pro-

pozim-programin e punës së LSHPM në vitin 2019, kishte sekretarja KE të LSHPM Stanka Trajkova. Në fjalimin e saj ajo potencoi:

-Aktivitetet në Programin për punë për vitin 2019, dalin nga synimet dhe detyrat e caktuara në Statutin e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Edhe në vitin 2019 postulatet themelore të Programit janë realizueshmëria, promovimi, përgjegjësia dhe optimalizimi. Krahas aktiviteteve të parapara tradicionale, siç është mbrojtja dhe të drejtat e SPI që nënkupton pagesë të rregullt të pensioneve dhe përshtatje të tyre me ndryshimet dhe plotësimet të buxhetit të RM, do të përcillet realizimi i reformës pensionale që

është në procedurë, ndërsa e cila përmbanë ndryshime dhe plotësime të rregullativës ligjore dhe implementim të saj, pastaj avancim të mbrojtjes shëndetësore të popullatës pensionale, të aktiviteteve në sport dhe jetën kulturo-argëtuese, zbatim të Vendimit për kriteret e vetme në punën materiale-financiare të shoqatave dhe Lidhjes, sjellje të Rregullores për matjet dhe kriteret në dhënien e mbështetjes financiare shoqatave të pensionistëve për aktivitetet e tyre, formim të Trupit koordinues të Aktiveve të pensionistëve në kuadër të LSHPM, ndërtim të shtëpive të pleqve dhe të pensionistëve që do të jenë të përshtatshme me shumën e pensioneve në Maqedoni dhe të tjerave. Kuptohet që programi është i hapur dhe se do të mund të plotësohet.

Në mbledhje janë shqyrtuar edhe miratuar Propozim-raporti financiar për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e realizuara për periudhën janar-tetor 2018 dhe Plani financiar për vitin 2019, të cilin e elaboroi Mitre Stojanovski, kryetari i Këshillit mbikëqyrës të LSHPM. Ai potencoi se edhe kundrejt aktiviteteve të shumta në vitin 2018, është punuar në mënyrë racionale dhe me kujdesin shumë të madh. (Kalina S. Andonova)



## Promovim për takim të gjeneratave

Promovimi i monografisë "Sporti në qytetin rreze malit Sharr - gjeneratat krijuese të sportit triumfues" nga profesori i pensionuar i edukatës fizike Dragoljub (Drashko) Haxhi Iljoski - Çajka kishte dy përmbajtje: prezantim i punimit në monografinë prej 170 faqeve dhe takim i mes gjeneratave të sportistëve dhe punonjësve sportiv nga Tetova 100 vite mbraja. Monografinë e promovuan d-r Nase Kondovski dhe Boris Momirovski. Përmbajtja e dytë e mbledhjes, e cila mund të thuhet që fitoi vend dominues është takimi i mes gjeneratave e cila kaloi në shenjë të përkujtimet të atyre të që e ndërtuan jetën sportive të Tetovës dhe një numri të madh prej tyre, individë ose kolektivë iu dhanë certifikata ose trofe. Autori i monografisë i njohur si Drashko Haxhi Iljoski i cili rrjedh nga një prej familjeve më sportive në Tetovë - Çajka dhe i cili ka merita të mëdha në zhvillimin e sportit, me sukses ka hulumtuar dhe ndërtuar përmbajtje, para të gjithave nga sportet "e vogla", ndërsa më së shumti për volejbollin në të cilin edhe si lojtar, trajner, selektues, ka kaluar më shume decenie nga jeta e tij. Monografia përmban fotografi nga e kaluara, e deri në kohët e sodit duke i emëruar ato të cilat kanë dhënë më së shumti kontribut në zhvillimin e disiplinave sportive të ndryshme dhe të cilat e kanë afirmuar sportin jo vetëm në Tetovë, por edhe në shumë hapësira më të gjëra. Në kujtimet e tij të vendosura në monografinë, Çajka i përmend klubet e skijimeve Ljuboten dhe Sharr të vitit 1934, klubin alpinist Ljuboten të vitit 1933, si dhe shumë klube të tjera nga një gamë e gjerë e sporteve të më hershme si ping-pong, tenis, karate, ndeshje, boks dhe shumë të tjerë.

## Mbështetje me të holla për 60 pensionistë

Praktika për shpërndarje të ndihmës së njëhershme me të holla për pensionistët para festave të fund vitit, vazhdon të zbatohet në Shoqatën e pensionistëve Çair, ku sipas Komisionit për shëndetësi për vitin 2018 është dhënë ndihmë me të holla 60 anëtarëve të shoqatës në shumën prej 3.000 denarëve, parvarësisht nga shumata e pensionit ose diagnozës së sëmundjes.

Mjetet u shpërndahen pensionistëve me pensione më të ulëta ose

anëtarëve me të ardhura më të ulëta në familje. Shfrytëzuesit e kësaj ndihme me të holla janë edhe familjet të pensionistëve me sëmundje më të rënda, pensionistë të cilët janë të ekspozuar ndaj furnizimit me barna më të shtrenjta si dhe të prekur nga fatkeqësi të ndryshme elementare.

Krahas kërkesës për dhënien e ndihmës, për çdo pensionist veçmas, kërkohet dhe mendim nga udhëheqësia e degës. Çdo kërkesë

për marrje të ndihmës së njëhershme me të holla duhet të ketë mbështetje dhe nënshkrim nga kryetari i degës, në të cilën është anëtar kërkuesi. Ashtu siç na informoi Mentor Qoku, kryetar i SHP Çair, ky lloj i mbështetjes me të holla, praktikohet më shumë vite, ndërsa mjetet e ndara për këtë qëllim nga viti në vit janë gjithnjë më të larta, si dhe numri i kërkesave.

"Komisioni i shqyrtoi të gjitha kërkesat të cilin ishin parashtruar pa-

varësisht nga shumata e pensionit dhe diagnozës së sëmundjes, i'u ishte shpërndarë ndihmë e njëhershme me të holla. Në programin është paraparë edhe shpërndarje e ndihmës së njëhershme edhe pensionistëve të tjerë për të cilët sugjerime dhe mendime do të vijnë nga degët. Me këtë ndihmë mundohemi në kufijtë e mundësive, të japim kontribut të veçantë në mbrojtjen e standardit të jetës së anëtarëve të shoqatës tone", deklaroi kryetari Mentor Qoku.

## Simulim i suksesshëm i shahut të LSHP të Shkupit

Më 21.12.2018 në sallën e LSHPM u mbajt simulimi i parë para vitit të ri i shahut me mjeshtrin ndërkombëtar Dimitar Ilievski. Në emër të organizatorit Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Qytetit të Shkupit, ka folur kryetari Metodija Novkovski, i cili i falënderoi mbështetësin, kryetarin e LSHPM Dragi Argirovski, ndërsa përshëndeti edhe prezencën e Salltir Karovski, nënkryetar i KE të LSHPM, menaxherin e projektit d-r Ilija Gligorov, referin ndërkombëtar Slobodan Mihajilovski - Masllovari si dhe mysafirët dhe pjesëmarrësit e tjerë Simulimin për të hapur e shpall mbështetësi Dragi Argirovski,

i cili theksoi: "Pjesëmarrës të nderuar, në shahun në Maqedoni simulimet kanë traditë të madhe. Të kujtojmë që në kryeqytetin e Maqedonisë simulime kanë luajtur shumë shahistë të theksuar, mes të cilëve edhe kampioni botëror rusi Anatolij Karpov, i cili në Shkup ishte mysafir në vitin 1976 dhe në vitin 1996. Gjatë viteve të kaluara simulime kanë luajtur edhe kampioni shumëvjeçar botëror nga Rusia Mihail Botvink, ukrainasit e njohur Eftim Geler dhe Aleksandar Bellavski, mjeshtri i madh Kiril Georgiev dhe të tjerë".

Nga shahistët e theksuar numër të madh të simulimeve ka luajtur

mjeshtri i njohur ndërkombëtar Dimitar Ilievski, aktivisti i theksuar pensional. Për atë LSHPM ka sponsoruar librin "Dimitar Ilievski, legjenda e shahut maqedonas nga autorët Nenad Batkoski, Dimitar Ilievski dhe Lubomir Hahi Manev. Pasi theksoi se simulimet kontribuojnë për rritjen e famës së lojës së 64 fushave të shahut kryetari Argirovski u uroi vitin e ri 2019.

Në takim morën pjesë 18 shahistë (prej të cilëve 6 gra) prej 12 shoqatave të Shkupit. Mjeshtri ndërkombëtar Dimitar Ilievski ka fituar me 13,5 kundrejt 4,5 pikë, shënoi 10 fitore, me 7 kundërshtarë ka luajtur bars dhe kishte vetëm një



humbje. Fitoren e vetme në simulim e realizoi pensionisti Dushko Surllovski nga SHP Ilinden, ndërsa gjysmë pike arritën të fitojnë Eftim Mishovski nga Shoqata e pensionistëve ushtarak, Pavle Ristovski nga SHP Butel, Pavlina Karaeva nga SHP Centar, Vasilka Topalloska nga SHP Kisella Vodë, Stojanko Traja-

noviq nga SHP Taftalixhe, Voislav Smilevski nga SHP Gazi Babë dhe Risto Kamçevski nga SHP Qendër. Pas përfundimit të lojrave të shahut Metodija Novkovski të gjithë garuesve u ndau mirënjohje për pjesëmarrje me shpresë se ky simulim i parë para vitit të ri do të bëhet tradicional. (I.G)